



2026 SHKURT

Mbrojtja në një muaj

mod.gov.al





FORCA TOKËSORE PAJISËT ME SISTEMIN RAKETOR “JAVELIN”

Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e dorëzimit të sistemit raketor “Javelin”, një kapacitet i ri për FARSH në kuadër të bashkëpunimit ushtarak me SHBA. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi se dorëzimi i sistemit “Javelin” përfaqëson një moment të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe në partneritetin strategjik me SHBA. Ndërsa, e ngarkuara me punë e SHBA në Shqipëri, Nancy VanHorn, e pranishme në këtë ceremoni, tha se ky moment është një dëshmi e fortë e përkushtimit të SHBA-ve për sigurinë në Rajon dhe aleancën e NATO-s.

★★★★★



MINISTRI PIRRO VENGU NË KONFERENCËN E SIGURISË SË MYNIHUT

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në Konferencën e Sigurisë së Mynihut, një nga platformat më të rëndësishme globale për sigurinë, ku në fokus të diskutimeve ishte forcimi i mbrojtjes dhe rritja e bashkëpunimit si garanci për stabilitet dhe siguri në një mjedis gjithnjë e më sfidues.

★★★★★

mod.gov.al

MM

A photograph of three men in dark suits and ties standing in front of a light-colored wall with a decorative relief. The man on the left wears glasses. The man in the center is bald. The man on the right has a beard. The text 'TAKIM TREPALËSH MES MINISTRAVE TË MBROJTJES' is overlaid in large, bold, green letters.

TAKIM TREPALËSH MES MINISTRAVE TË MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, u takua me homologun kroat Ivan Anušić dhe me ministrin e Mbrojtjes të Kosovës Ejup Maqedonci në Konferencën e Sigurisë në Mynih, në një moment kur mjedisi i sigurisë në Evropë dhe rajon karakterizohet nga dinamika të shtuara dhe nevoja për përgjigje të koordinuara, ndërsa diskutimet u fokusuan në thellimin e bashkëpunimit në mbrojtjen e përbashkët, rritjen e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura, zhvillimin e industrisë ushtarake dhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme mbrojtëse.

★★★★★

mod.gov.al




VENGU VIZITË ZYRTARE NË HUNGARI

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Hungari ku u takua me homologun e tij Kristóf Szalay-Bobrovniczky, me të cilin mbajti edhe një konferencë të përbashkët për shtyp, duke riafirmuar partneritetin e ngushtë mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe integritetit evropian, ndërsa u nënshkruan edhe dy marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe inovacionit.

★★★★★

mod.gov.al

MM



MBROJTJA 2030, TRANSPARENCË DHE MODERNIZIM

Në konferencën e radhës për mediat, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu së bashku me SHSHPFA Gjenerallejtënant Arben Kingji, Drejtorin e AKMC, Haki Çako dhe Drejtorin e Agjencisë për Industrinë e Mbrojtjes, Dorian Tola prezantuan punën për modernizimin e pajisjeve ushtarake, rritjen e gatishmërisë operacionale, përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave civile dhe zhvillimin e industrisë së mbrojtjes si sektor strategjik për sigurinë dhe ekonominë e vendit.

★★★★★

mod.gov.al

MM



TRAJNIMI “FIRE PHOBIA”

Efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut zhvilluan në Pejë trajnimin “Fire Phobia” në bashkëpunim me trupat hungareze në kuadër të angazhimeve stërvitore në misionin e KFOR, me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë mes aleatëve të NATO në funksion të operacioneve të mbështetjes së paqes dhe garantimit të sigurisë.

★★★★★

mod.gov.al

MM



XHENIOT, OPERACIONE EOD NË TRE BASHKI

Batalioni i Xhenios ka realizuar tre operacione EOD në bashkitë Elbasan, Delvinë dhe Mirditë, ku kryeoperatorët EOD kryen vlerësimin e municioneve luftarake të identifikuara dhe më pas lëvizjen e transportimin e tyre në ambientet e përcaktuara.

★★★★★

mod.gov.al

MM



KORRIDORI VIII, INFRASTRUKTURË KRIKKE E NATO-S

Korridori 8, me pikënisje në kompleksin portual Durrës - Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi, është përfshirë zyrtarisht në planet dhe infrastrukturën kritike ushtarake të NATO duke u njohur si korridor sigurie për mbrojtjen kolektive të Aleancës, ndërsa vendimi u bë i ditur nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu në përfundim të Ministerialit të mbajtur në Bruksel.

★★★★★

mod.gov.al

MM



MEMORANDUM SHQIPËRI – URDHRI SOVRAN I MALTËS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi me synim rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit për emergjencat civile si dhe përmirësimin e mbështetjes mjekësore në situata krize.



mod.gov.al

MM



MINISTRI VENUGU: INVESTIME STRATEGJIKE NË FORCËN AJRORE

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vizitoi disa prej infrastrukturave kritike të Forcës Ajrore me fokus të veçantë sistemet e radarëve ajrorë, duke theksuar se Forca Ajrore ndodhet në një proces investimesh domethënëse që synojnë përmirësimin e teknologjisë ekzistuese dhe zgjerimin e kapaciteteve operacionale.

★★★★★